



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.463/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë parashtruar kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore, me seli në Mitrovicë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.463/2025, e datës 08.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe, paraqitur kundër Subjektit Politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 08.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.463/2025, nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Komuna Mitrovicë parashtruar kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore në të cilën pretendon se të rinjtë e subjektit politik Lista Serbe me datë 07 shkurt 2025, në orën 19:00, gjatë monitorimit të aktiviteteve të subjekteve të tjera politike, kanë vërejtur se subjekti politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore, i çertifikuar për zgjedhjet e datës 09.02.2025, në fletën e votimit me numër rendor 126, vendosi postera të subjektit politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore në shtyllë të ndriçimi elektrik në vendin Rudarë, të Komunës së Zveçanit.

Me vendosjen e simboleve të partisë në shtyllën e ndriçimit publik, mendojmë se subjekti i lartpërmendur ka shkelur dispozitat e nenit 34, paragrafi 1, nënparagafi 1.2. i cili thotë: Gjatë periudhës së fushatës, një subjekti politik, mbështetësve ose kandidatëve të tij i ndalohet të

bëjnë ndonjë nga sa vijon: Vendosja e njoftimeve, pankartave dhe posterave, ose ndryshe vendosjen e emrave ose sloganeve të tyre në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave ose objekteve publike, në ose mbi rrugë publike, në shenja të komunikacionit publik, brenda ose jashtë objekteve të uzurpuara ose ndryshe të cilat i shfrytëzojnë organizatat ndërkombëtare, brenda ose jashtë ndërtesave ose hapësirave private me lejen e pronarit apo përdoruesit. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur Foto e një shtylle me poster të subjektit politik Iniciativa Qytetare Drejtësi Popullore e vendosur në rrugën kryesore në Rudar, komuna e Zveçanit.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore ka theksuar së pari, fotografia e dorëzuar është me cilësi të keqe, dhe se nuk mundet me siguri të përcaktohet ku është regjistruar. Nëse shikohet me kujdes fotoja me ngjyra, prapa shtylles së betonit, në të cilën kinse gjendet posteri i GI Drejtësia Popullore, shihet një automjet pasagjeresh. Në anën e djathtë të shtyllës duket një objekt me dritare, ndërsa në afërsi, po ashtu djathas, sipas vlerësimit tim ka një betoni. Në bazë të kësaj fotografie, nuk është e mundur të konstatohet vendndodhja e xhirimeve, pasi nuk shihet asfalti apo ndonjë veçori tjeter e rëndësishme. Gjithashtu është e pakjartë nëse shtylla e betonit është në pronë private apo shtetërore. Prandaj, e vetmja dëshmi që ofron Lista Serbe janë fjalët dhe pretendimet e Zlatan Elekut. Ekziston edhe një mundësi po është foto fotomontazh ose është e regjistruar në pronë private. Parashtruesi i përgjigjies në ankesë po ashtu ka theksuar se vendi Rudarë është një vendbanim i vogël pranë rrugës kryesore Leposaviq-Mitrovicë - Prishtinë, ndërsa një pjesë më e shkurtër e rrugës të çon në Zveçan. Pretendimet e mia i bazoj në faktin se jetoj dhe punoj në Rudarë dhe e njoh shumë mirë vendin. Nisur nga kjo, mund të konstatoj me bindje se shtylla e betonit me objektet e parashtruara në fotografinë e dorëzuar nuk ekziston në Rudarë. Si dëshmi për këtë po ju bashkëngjis tre video inçizime të bëra më 09.02.2025.

Në incizimin e parë dhe të dytë, të shënuara me numrat 1 dhe 1-1, shihet se në pjesën nga dalja nga Grabovci deri te kthesa për në Manastirin e Sokolicës, në rrugën kryesore për në Prishtinë, nuk ka shtylla betoni me postera të GI Drejtësia Popullore, si dhe objektet e paraqitura në fotografinë e dorëzuar. Në incizimin e tretë, të shënuar me numrin 2, që fillon nga kthesa për në Manastirin e Sokolicës dhe vazhdon në drejtim të Zveçanit, shihet se shtyllat në atë pjesë janë prej betoni, por në to nuk ka postera të partisë së Drejtësisë Popullore, dhe as objektet e parashtruara në fotografinë e Listës Serbe. E gjithë kjo tregon kuartë se kjo është një akuzë e rrejshme, e sajuar, pas së cilës qëndron qëllimi i kuartë i Listës Serbe për t'u hakmarrë ndaj GI Drejtësia Popullore për ankesën që parashtruan ma parë, në bazë të së cilës ata u dënuan për tubimin e tyre parazgjedhor në Zubin Potok.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

**- Ankesa është e pa bazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Drejtësia Popullore, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Lista Serbe, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve*”, pasi që nuk mund të identifikohet qartë posteri i vendosur në shtyllë elekrike dhe nuk dihet qartë se vendi i pretenduar nga pala ankuese është fshati Rudar, komuna e Zveçanit.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk ka mundr të vërtetohet se në cilën kohë dhe vend ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tillë janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtruesat  
Anr.463/2025 datë 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.